

Zyra e Burimeve Njerëzore

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune të R. Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 62/2005), Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë shpall :

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës me kohë të caktuar deri më 31.08.2014

Drejtor i Zyrës së Financës

Qëllimi primar i pozitës: Të udhëheq dhe drejtoj Zyrën e Financave, të ofroj shërbime financiare cilësore dhe të sigurojë funksionim dhe menaxhim të saktë dhe efikas dhe raportim të politikave, proceseve dhe procedurave të Zyrës së Financave si dhe të përfaqësojë Zyrën dhe Universitetin për të siguruar dhe ruajtur suksesin dhe reputacionin e mirë.

Të bëjë ristrukturimin e zyrës dhe optimizimin e resurseve të stafit të zyrës së financave.

Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligji, kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet që vijojnë:

Thelbësore:

- Diplomë universitare në administrim biznesi, ekonomi ose lëmi të ngjashme ose kualifikim ekuivalent profesional;
- Tre vjet përvojë pune në ekonomi dhe kontabilitet;
- Përvojë në koordinimin efektiv të shërbimit;
- Njohje të shkëlqyeshme mbi praktikën e mirë në financa;

Preferohet:

- Magjistraturë në administrim biznesi, ekonomi ose lëmi të ngjashme ose kualifikim ekuivalent profesional;
- Përvojë pune në institucion të arsimit të lartë;
- Kualifikim profesional në lëmi të ngjashme;

Kandidati duhet të posedojë shkathtësi dhe aftësi:

Themelore:

- Komunikim efektiv (gojor dhe i shkruar) në dy gjuhët që përdoren në nivel të Universitetit (shqip, maqedonisht) dhe kontribut për implementimin e politikës gjuhësore;
- Aftësi për ta motivuar dhe koordinuar stafin;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme ndërnjerëzore dhe komunikative (gojore dhe të shkruara);
- Aftësi për të udhëhequr dhe punuar në ekip;
- Aftësi për të analizuar dhe zgjidhur të dhëna dhe çështje të ndërlikuara;
- Aftësi për të funksionuar duke patur parasysh mbrojtjen e të dhënave dhe fshehtësisë;
- Pjesëmarrje të shkëlqyer dhe përpikëri dhe shfrytëzim efikas të orarit të punës;
- Shkathtësi të shkëlqyera organizative;
- Aftësi për vetë – motivim, të ndërrmer iniciativa dhe të menduarit kreativ si dhe të punojë në mënyrë fleksibile;
- Mundësi për t'i dhënë prioritet vëllimit të punës që me sukses të kryhet brenda afatit kohor dhe aftësi për të punuar nën presion;
- Aftësi për të negociuar dhe të qetësojë konfliktet dhe të zgjidh problemet;
- Aftësi për të përdorur Teknologjinë e Informatikës dhe sistemet kompjuterike të Universitetit;
- Aftësi për bashkëpunim pozitiv me studentët;
- Dëshirë për të ndërmarrë dhe mbajtur trajnime;
- Zotim dhe besnikëri ndaj Universitetit dhe misionit të saj si prioritet më të lartë

Preferohen:

- Komunikim efektiv (gojor dhe i shkruar) në tre gjuhët që përdoren në nivel të Universitetit (shqip, maqedonisht dhe anglisht);
- Aftësi dhe dëshirë për të udhëtuar kur është e nevojshme;

Fillimi dhe përfundimi i kohës ditore dhe javore të punës: **Nga ora 08,00 deri 16,00, nga e hëna deri të premten.**

Paga bazë: **1050 € (64.575 MKD)**

Afati i dorëzimit të aplikacioneve është **8** ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Konkursi është i shpallur nga 22.10.2013 deri më 29.10.2013

Ju lutemi e dërgoni aplikimin për punësim nëpërmjet e-mailit: jobs@seeu.edu.mk (**Aplikacion valid do konsiderohet vetëm aplikacioni i plotësuar që gjendet në ueb faqen e Universitetit, në rubrikën Konkurse. Çdo lloj tjetër forme aplikacioni nuk do merret parasysh.**)

Adresa

Universiteti i Evropës Juglindore
Zyra e Burimeve Njerëzore
Bul. "Ilinden" nr. 335
1200 Tetovë, Maqedoni
Telefoni për kontakt: 044 356 087